

## GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës:                   **PAKR 46/13**

Data:                               **28 mars 2013**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarës së EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati, kryetare e kolegjit dhe gjyqtare raportuese, si dhe gjyqtarëve Abdullah Ahmeti dhe Xhevdet Abazi si anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e Beti Hohler, zyrtare ligjore e EULEX-it, e cila vepron në cilësinë e procesmbajtëses,

në procedurën penale kundër

**A. B.**, i lindur më ... në ..., i biri i B. e Rr. B. e gjinisë A., banor i Kosovës, me shkollim fillor, beqar, me profesion punëtor, me gjendje ekonomike mesatare, pa dënime të mëhershme, në paraburgim që nga data 21.10.2010;

i shpallur fajtor në shkallën e parë për veprën penale të *Vrasje* në pajtueshmëri me nenin 146 të Kodit Penal të Kosovës (KPK, në fuqi deri më 01.01.2013) me aktgjykimin nr. P 87/11 të datës 03.06.2011 të Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe i dënuar me burgim prej 15 (pesëmbëdhjetë) vjet dhe i detyruar të kompensoj shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 800,00 EURO dhe shumën e caktuar prej 100,00 EURO;

**duke vepruar sipas ankesës së përbashkët të avokatëve mbrojtës Haxhi Cekaj, Aziz Rexha dhe Gafur Elshani të ushtruar më 04.08.2011 kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë nr. P 87/11 të datës 03.06.2011,**

*pas shqyrtimit të përgjigjes së Prokurorit të Apelit të Shtetit të Kosovës nr. PPA 340/11 të datës 22.09.2011, të paraqitur më 27.09.2011;*

*pas mbajtjes së seancën së hapur publike më 28.03.2013 në praninë e të akuzuarit, avokatëve mbrojtës Haxhi Cekaj, Aziz Rexha dhe Gafur Elshani, si dhe prokurorit të shtetit Haxhi Derguti;*

*pas këshillimit dhe votimit më 28.03.2013,*

*në pajtueshmëri me Nenin 420 dhe zbatimin e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK)*

*lëshon këtë*

---

### AKTGJYKIM

---

**I. Ankesa e përbashkët e avokatëve mbrojtës Haxhi Cekaj, Aziz Rexha dhe Gafur Elshani, e ushtruar më 04.08.2013 në emër të të pandehurit A. B. kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë nr. P 87/11 të datës 03.06.2011, pjesërisht pranohet.**

**II. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë nr. P 87/11 i datës 03.06.2011, NDRYSHOHET lidhur me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit me sa vijon:**

**I pandehuri A. B. (i lindur më ...), i shpallur fajtor për *Vrasje* në pajtueshmëri me nenin 146 të KPK-së, dënohet me 9 (nëntë) vjet burgim. Koha e kaluar në paraburgim nga 21.10.2010 do të llogaritet në dënim.**

**III. Arsyet e tjera të ankesës së mbrojtjes refuzohen, dhe në pjesën mbetëse aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë nr. P 87/11 i datës 03.06.2011, vërtetohet.**

### ARSYETIMI

#### **I. Historiku i procedurës së lëndës**

1. Ngjarjet e ngritura në këtë lëndë penale kanë ndodhur më 31.01.2005, rreth orës 11.25, në rrugën kryesore Pejë-Deçan, respektivisht në rrugën e ‘TMK’, kur S. M. u qëllua dhe ditën e nesërme vdiq në kampin ‘Bondsteel’ në Kosovë si rezultat i të shtënave të marra.

2. Zyra e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (tash e tutje: PSRK, Prokurori Special) më 04.02.2011 ngriti në (atëherë) Gjykatën e Qarkut në Pejë, aktakuzën nr. PPS 109/10 të datës 25.01.2011 kundër **A. B.** Aktakuza pretendonte përgjegjësinë e të akuzuarit për vdekjen e S. M. duke e akuzuar për veprën penale të *Vrasje e rëndë* në pajtueshmëri me nenin 147 nën paragrafin (9) të KPK-së.

3. Aktakuza u konfirmua tërësisht me aktvendimin e gjyqtarit për konfirmim nr. KA 40/11 të datës 01.03.2011.

4. Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në mes të datës 05.04.2011 dhe 03.06.2011 në Gjykatën e Qarkut në Pejë.

5. Më 03.06.2011 trupi gjykues nxori aktgjykimin nr. P 87/2011 përmes të cilit i akuzuari **A. B.** u shpall fajtor për veprën penale *Vrasje* në pajtueshmëri me Nenin 146 të KPK-së dhe rrjedhimisht u dënua më 15 (pesëmbëdhjetë) vjet burgim. Trupi gjykues caktoi se koha e kaluar në paraburgim që nga data 21.10.2010 deri më 03.06.2011 do të llogaritet në dënimin e të akuzuarit. Trupi gjykues më tej caktoi që i akuzuari të kompensojë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 800 EURO dhe shumën e përcaktuar prej 100 EURO. Me rastin e nxjerrjes së vendimit të tij, trupi gjykues shtyu edhe paraburgimin kundër të akuzuarit derisa aktgjykimi të merr formën e prerë.

6. Mbrojtja ushtroi ankesë kundër aktgjykimit më datën 04.08.2011. Pas një kohe të shkurtër, shkresat e lëndës janë transferuar në Gjykatën Supreme të Kosovës si gjykatë kompetente e shkallës së dytë në atë kohë. Në pajtueshmëri me Nenin 39 Paragrafin (1) të Ligjit mbi gjykatat, Ligji nr. 03/L-199, lënda i është transferuar Gjykatës së Apelit më 01.01.2013 si gjykatë (e re) kompetente e apelit.

#### **II. Gjetjet e Gjykatës së Apelit**

##### **1. Kompetenca e Gjykatës së Apelit**

7. Gjykata e Apelit është gjykatë kompetente për të vendosur mbi ankesën në pajtueshmëri me nenin 17 dhe nenin 18 të Ligjit mbi gjykatat (Ligji nr. 03/L-199).

8. Kolegji i Gjykatës së Apelit është formuar në përputhshmëri me nenin 19 paragrafin (1) të Ligjit mbi gjykatat dhe nenin 3 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03/L-053). Në pajtueshmëri me vendimin e kryetarit të asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it të datës 18.03.2013, në përputhshmëri me Nenin 3.7. të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, kolegji ka qenë në përbërje prej një gjyqtari të EULEX-it dhe dy gjyqtarëve të apelit të Kosovës.

## **2. Ligji procedural i zbatueshëm - *mutatis mutandis* Kodi i Procedurës Penale të Kosovës në fuqi deri më 31.12.2012**

9. Ligji procedural penal në fuqi në lëndën penale përkatëse është Kodi i procedurës penale të Kosovës (i vjetri) që ishte në fuqi deri më 31.12.2012.<sup>1</sup> Interpretimi i duhur i dispozitave kalimtare të Kodit të Procedurës Penale (KPP) (të ri) në fuqi që nga 01.01.2013, përcakton se në procedurën penale të iniciuar para hyrjes në fuqi të Kodit të ri, për të cilën gjykimi tashmë ka filluar por nuk ka përfunduar me vendim të formës së prerë, do të zbatohen *mutatis mutandis* dispozitat e KPPK-së derisa vendimi të marr formën e prerë. Lidhur me këtë është përmendur Mendimi Juridik nr. 56/2013 i Gjykatës Supreme të Kosovës, i miratuar në seancën e përgjithshme të saj më datë 23.01.2013.

## **3. Pranueshmëria e ankesës**

10. Aktgjykimi i kundërshtuar është shpallur më 03.06.2011. Aktgjykimi me shkrim i është dërguar të akuzuarit më 02.08.2011. Ankesa e përbashkët e avokatëve mbrojtës të të akuzuarit është ushtruar më datë 04.08.2011. Gjykata e Apelit konstaton se ankesa është ushtruar nga personi i autorizuar dhe në kohë në përputhshmëri me nenin 398 paragrafin (1) të KPPK-së dhe nenin 399 paragrafin (1) të KPPK-së.

## **4. Gjetjet mbi meritat**

### **4.1. Parashtrësit e palëve**

11. Avokatët mbrojtës ushtruan ankesën e tyre të përbashkëta mbi të gjitha bazat në pajtueshmëri me nenin 402 paragrafin (1) të KPPK-së: mbi bazën e shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe lidhur me vendimin për sanksionin penale të shqiptuar. Mbrojtja i propozon Gjykatës së Apelit të modifikojë aktgjykimin e kundërshtuar në atë mënyrë që të lirojë të akuzuarin apo në mënyrë alternative të prish aktgjykimin dhe të kthejë lëndën në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim. Prokuroi i Shtetit i Apelit shtynë gjykatën të refuzoj ankesën në tërësinë e saj dhe të vërtetoj aktgjykimin e kundërshtuar.

### **4.2. Pretendimet për shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale**

12. Mbrojtja pohon për shkelje të përshkruar në nenin 403 paragrafin (1) nën paragrafin 12) të KPPK-së dhe shkelje të nenit 391 paragrafit (1) në lidhje me nenin 403 paragrafin (2) nën paragrafin 1) të KPPK-së. Mbrojtja pohon se dispozitivi i aktgjyimit të kundërshtuar është në

---

<sup>1</sup> Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, në fuqi që nga 06.04.2004 deri më 31.12.2012.

kundërshtim me arsyet e sjella në aktgjykim dhe se në arsyetimin e tij trupi gjykues nuk ka shtjelluar mbi faktet vendimtare. Mbrojtja më tej pohon se dispozitivi është një përshkrim i thjeshtë i ngjarjes kritike dhe paraqitet i ndarë nga faktet dhe provat relevante në lëndë. Ata pohojnë se dispozitivi nuk përmban deklaram të motivit dhe paramendimit për vrasje të cilat janë elemente thelbësore për të përcaktuar jo vetëm gjendjen faktike por edhe veprën penale si të tillë. Po ashtu është argumentuar se dispozitivi nuk përmend përfshirjen e B. Z. apo faktin se viktima S. M. ishte i armatosur. Sipas Mbrojtjes, duke vepruar në këtë mënyrë, gjykata e shkallës së parë ka ndryshuar përshkrimin faktik të veprës penale.

13. Prokurori i Shtetit kundërshton parashtrirat e Mbrojtjes për shkeljet më lart.

14. Gjykata e Apelit konstaton se dispozitivi nuk kundërshton arsyet e sjella në aktgjykim. Dispozitivi sjell një përshkrim të qartë të kuptueshëm të fakteve vendimtare duke përfshirë atë se i akuzuari nuk ka vepruar në mbrojtje të nevojshme sikurse përcaktohet me nenin 8 të KPK-së. Nuk ka kundërthënë në mes të analizës së fakteve dhe provave në pjesën e arsyetimit të aktgjykimit dhe dispozitivit. Analiza e bërë nga trupi gjykues korrespondon me konkluzionin e dispozitivit.

15. Gjykata e Apelit rithekson se nuk është e nevojshme që dispozitivi të përmbajë çdo detaje të ngjarjes kritike. Neni 396 paragrafi (3) i KPPK-së përcakton përmbajtjen e dispozitivit duke iu referuar nenit 391 të KPPK-së. Në kuadër të përshkrimit të veprës penale, atë çfarë *medoemos* do të përmbajë dispozitivi janë “ *faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale të kryer nga i akuzuari si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të kodit penal.* ”. Në lëndën penale në fjalë – kjo do të thotë përshkrim i veprimeve të të akuzuarit që ka qar trupin gjykues në konkluzionin se i akuzuarit në mënyrë të kundërligjshme ka privuar nga jeta S. M.. Veçantitë e ngjarjes dhe veprimeve të personave pjesëmarrës, duke përfshirë praninë e B. Z., shkëmbimi i fjalëve në mes të viktimës dhe të akuzuarit dhe nëse i akuzuari ka vepruar në mbrojtje të nevojshme, janë në mënyrë korrekte, hollësisht të shtjelluara në pjesën e arsyetimit të aktgjykimit.

16. Në pjesën e arsyetimit të aktgjykimit, trupi gjykues shtjellon se cilat fakte i gjen të provuara dhe jo të provuara dhe arsyet për konkluzione të tilla. Trupi gjykues nuk ka ndryshuar përshkrimin e veprës penale, kjo e fundit mbetet e njëjta sikurse në aktakuzë përveç se është rregulluar në gjetjet e procedurës së provave gjatë shqyrtimit gjyqësor.

17. Nga pjesa e arsyetimit të aktgjykimit është e qartë se trupi gjykues me kujdes ka konsideruar rolin e B. Z., faktin se S. M. ishte i armatosur dhe rrethanat e tjera relevante. Përfshirja e këtyre fakteve në dispozitiv nuk do të ndryshonte konkluzionet sikurse në mënyrë të gabuar është argumentuar nga mbrojtja. Ajo çfarë është e rëndësishme, është se këto fakte janë shqyrtuar nga trupi gjykues dhe në mënyrë adekuate janë adresuar, siç shihet nga pjesa e arsyetimit të aktgjykimit. Gjykata e Apelit nuk gjen asnjë shkelje të nenit 391 paragrafi (1) të KPPK-së.

18. Për më tepër, argumenti i ankesës se dispozitivi nuk përmban se S. M. ishte i armatosur, është faktikisht, i gabuar. Në fakt, dispozitivi *përmban* se S. M. ishte “në posedim joligjor të një revole dhe granate dore.”

19. Lidhur me argumentin se dispozitivi nuk përmend motivin dhe paramendimin e të akuzuarit për vrasjen e S. M., Gjykata e Apelit vëren se për të ekzistuar vepra penale përkatëse, nuk është e nevojshme që i akuzuari të veprojë me një motiv specifik. Arsyet (motivi) *pse* i akuzuari ka privuar nga jeta S. M. nuk përbën një element të veprës penale të *Vrasje* në pajtueshmëri me nenin 146 të KPK-së. Në anën tjetër, motivi i të akuzuarit ka mundur të jetë relevant për cilësimin e veprës si *Vrasje e rëndë* në pajtueshmëri me nenin 147 pika 9) të KPK-së, por ky cilësim i prokurorisë u refuzua nga trupi gjykues. Dispozita e fundit në fakt përcakton në të vërtetë që kryerësi “*privon nga jeta personin tjetër nga hakmarrja e paskrupullt apo nga motive të tjera të ulëta;*”, ndërsa *Vrasja* nga nenin 146 i KPK-së kryhet nga “*kushdo që e privon personin tjetër nga jeta.*”

20. Mbrojtja gjithashtu argumenton se trupi gjykues ka manipuluar me dëshminë e dëshmitarit B. Z. duke mos përmendur pjesët shfajësuese të deklaratës së tij në aktgjykim. Gjykata e Apelit refuzon këtë argument të Mbrojtjes. Trupi gjykues u ka bërë adresim gjithëpërfshirës deklaratave të këtij dëshmitari të dhëna gjatë hetimit dhe para gjykatës dhe ka përshkruar mospërputhjet në mes të deklaratave si dhe cilin version e ka konsideruar më të besueshëm. Edhe pse nuk e ka ritheksuar *tekstualisht*, kolegji ka përshkruar esencën e deklaratës së tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor më datë 06.04.2011 për të cilën mbrojtja në ankesë pretendon se është lënë jashtë aktgjykimit. Po ashtu është me rëndësi të vërehet se gjykata nuk është e obliguar e as aktgjykimi nuk ka për qëllim të përsëris në tërësi dëshmitë e dëshmitarit. Obligim i gjykatës është të *analizoj* provat dhe të vlerësoj cilat fakte i konsideron të provuara e cilat jo si dhe të vlerësoj besueshmërinë e provave të cilat janë ndesh me njëra tjetrën. Gjykata e Apelit vëren se arsyetimi i trupit gjykues duhet të lexohet si tërësi. Trupi gjykues ka shtjelluar në hollësi të mjaftueshme kundërthëniet në mes të provës së B. Z. gjatë shqyrtimit gjyqësor kur ka krahasuar deklaratimet e tij të mëhershme. Trupi gjykues po ashtu, në përputhshmëri të plotë me nenin 496 paragrafin (7) të KPPK-së, vlerëson besueshmërinë e provave që bien ndesh me njëra tjetrën dhe arsyet pse nuk e konsideron të besueshme dëshminë e dhënë para trupit gjykues kur i vendos kundër deklaratimeve të mëhershme të dëshmitarit.

21. Gjykata e Apelit në mënyrë eksplicite refuzon pohimin se arsyetimi i aktgjykimit është konfuz, kontradiktor dhe kundërshton dispozitivin. Gjykata e Apelit vëren se pohimi i mbrojtjes për këtë çështje është bërë në kondita të përgjithshme pa asnjë përmendje të caktuar. Kjo nuk është befasuese pasi që Gjykata e Apelit nuk gjen mospërputhje të tilla në aktgjykim.

22. Gjykata e Apelit megjithatë gjen se aktgjykimi nuk shtjellon elementin subjektiv të përgjegjësisë penale të të akuzuarit respektivisht shtjellimin e dashjes nga ana e të akuzuarit. Gjykata e Apelit megjithatë konstaton se edhe pse dashja nuk është shtjelluar në mënyrë specifike në aktgjykim, nga gjetjet faktike të trupit gjykues dhe arsyesimit të tij është e qartë se trupi gjykues konstatoi se i akuzuari ka vepruar me dashje dhe se po ashtu ishte mendërisht i aftë. Trupi gjykues po ashtu përmend nenin 11 të KPK-së si bazë të vendimit të tij pra vë në pah vërtetimin e elementit subjektiv.

#### **4.3. Pretendimet për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike sipas nenit 405 të KPPK-së**

23. Mbrojtja kundërshton përcaktimin faktik të trupit gjykues lidhur me përfshirjen e B. Z.. Mbrojtja argumenton se ky i fundit ishte pjesëmarrës aktiv i incidentit në mes të të akuzuarit dhe

S.M.. Mbrojtja më tej argumenton se S.M. ka grushtuar të akuzuarin në fytyrë duke nxitur incidentin, nxori armën ndaj të akuzuarit dhe se B.M. shkrepiti të shtënë e parë.

24. Mbrojtja kundërshton gjetjet faktike duke theksuar (i) se i akuzuari dhe S. M. janë fjalosur (ii) se S. M. kapi dorën e të akuzuarit dhe (iii) se S. M. nxori armën e tij ndaj të akuzuarit. Gjykata e Apelit vëren se trupi gjykues pranoi në gjetjet e tij faktike se një shkëmbim fjalësh ndodhi në mes të të akuzuarit dhe S. M. dhe se një ngacmim ndodhi në mes tyre. Kjo pjesë e mbrojtjes që kundërshton gjetjet faktike prandaj është arkaike. Dy çështjet relevante për aktgjykimin fajësues të ngritura nga mbrojtja e që duhet të adresohen nga Gjykata e Apelit janë (i) nëse S. M. filloi sulmin dhe (ii) nëse ai në fakt nxori armën kundër të akuzuarit. Gjykata e Apelit përsëri rithekson se gjykata është e obliguar të vërtetoj faktet *relevante* në të cilat bazohet gjetja e veprës penale dhe përgjegjësia e të akuzuarit.

25. Mbrojtja ka theksuar më tej përshkrimin faktik të incidentit si në vijim: i akuzuari ishte duke kaluar nga viktima dhe B.Z., kur B.Z. fuqishëm u përplas në te. Me tu kthyer për të parë kush u përplas në të, S. M. i bërtiti duke thënë “Ndal, ndal”, e kapi dhe i tha “Jeta jote mori fund, do ta shkërdhej nënën”. Pastaj S. M. e grushtoi të akuzuarin në anën e majtë të fytyrës. I akuzuari pastaj dëgjoi një të shtënë arme. Në përlëshje me S. M. ky i fundit nxori armën dhe i akuzuari e kapi S. M. në dorë. Pastaj ai dëgjoi të shtënë e dytë. Pas kësaj ai u orvat të largohet nga S. M. por nuk mundi sepse S. M. e kapi atë për dore. I akuzuari pastaj nxori armën e vet dhe gjuajti në drejtim të S. M.. Atij nuk i kujtohet sa herë ka gjuajtur në S. M..

26. Kur bëhet fjalë për dëshminë e dhënë nga dëshmitari B.Z., Gjykata e Apelit gjen se trupi gjykues e ka konsideruar dëshminë e këtij dëshmitari të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor në disa aspekte të rëndësishme materiale - kontradiktore me dëshmitë e tij të mëhershme. Trupi gjykues ka ripërsëritur dëshmitë e ndryshme nga ky dëshmitar dhe ka përmendur mospërputhjet në mes tyre (shih faqen 8 dhe vazhdimin pastaj përsëri faqen 27 dhe vazhdimin e aktgjyqimit të kundërshtuar).

27. Trupi gjykues ka pranuar në bazë të dëshmisë së B.Z.dhe të dëshmitarëve të tjerë se në një farë forme ka pasur shkëmbim fjalësh në mes të të akuzuarit dhe të S. M.. Gjykata e Apelit konfirmon këtë gjetje dhe pajtohet plotësisht në këtë aspekt me vlerësimin e provave nga ana e trupit gjykues.

28. Trupi gjykues nuk ka pranuar se S. M. e ka sulmuar të akuzuarin. Trupi gjykues ka theksuar se dëshmitari B.Z., para dhënies së dëshmisë së tij më datën 6 prill 2011, nuk ka përmendur askund se S. M. i kishte rënë shpullë të akuzuarit. Në dëshmitë e veta të datave 31.01.2005, 01.02.2005, 03.02.2005, 12.02.2005 dhe 08.11.2010 B.Z. kurrë nuk ka thënë se S. M. i kishte rënë shpullë të akuzuarit. Gjatë vlerësimit të besueshmërisë së këtij dëshmitari, trupi gjykues ka pranuar dëshmitë e mëhershme si dëshmi më të besueshme sesa dëshminë e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Gjykata e Apelit pajtohet plotësisht me vlerësimin e trupit gjykues në këtë drejtim. B.Z., po të kishte qenë vërtet dëshmitar kur S. M. i kishte rënë shpullë të akuzuarit, do ta kishte përmendur një gjë të tillë në dëshmitë e veta të dhëna menjëherë pas incidentit ose në ndonjërin prej dëshmive të radhës të cilat i njëjti i kishte dhënë më datat 01.02.2005, 03.02.2005, 12.02.2005, 08.11.2010. Gjykata e Apelit nuk pajtohet me shpjegimin B. Z. iu kishte kujtuar ngjarja më qartë vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor. Përderisa ka mundësi që dëshmitari ka qenë nën stres gjatë dhënies së dëshmisë së parë menjëherë pas ngjarjes dhe do të ishte e arsyeshme të konstatohej se i njëjti ka mundur të harronte të përmendte aspekte të caktuara, më vonë një gjë e

tillë nuk ka mundur të ndodhte, gjatë dhënies së dëshmimeve në shkurt 2005 apo madje edhe në nëntor 2010. Deri në dhënien e këtyre dëshmimeve, dëshmitari do të kishte menduar me kujdes rreth kësaj ngjarjeje. Dëshmitari kishte ndryshuar dëshminë vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor të cilën gjë Gjykata e Apelit e konsideron si një përpjekje për t'i ndihmuar mbrojtjes në çështjen e tyre.

29. Lidhur me posedimin e armëve nga S. M., Gjykata e Apelit në mënyrë specifike vëren se B.Z. kurrë nuk ka pohuar se S.M. kishte nxjerrë revolen në drejtim të të akuzuarit. Ai ka qenë i qëndrueshëm në deklarinimin e vet duke përfshirë këtu edhe dëshminë në shqyrtimin gjyqësor se S.M. nuk kishte pasur revole në dorë.

30. Nuk është kontestuese se B.Z. kishte hapur zjarr nga revolja e vet gjatë konfrontimit. Vetë dëshmitari ka dëshmuar për këtë. Ai kishte deklaruar se kishte shkrepur tri apo katër herë nga revolja, megjithëse vetëm një gëzhjojë nga arma e tij (kalibri 7.62 mm) ishte gjetur në vendin e kriminit. Trupi gjykues megjithatë kishte pranuar mundësinë se disa prej këtyre gëzhjovave kanë mundur të humbin për shkak të borës. Ky është një konstatim i arsyeshëm. Çështja është nëse B.Z. kishte shtënë i pari siç pretendon mbrojtja dhe cilat mund të kishin qenë pasojat e këtyre të shtënave për argumentet e mbrojtjes së pohuar të domosdoshme, nëse kishte pasoja të tilla.

31. I akuzuari kishte deklaruar se kishte dëgjuar të shtënë nga revolja – dhe vërtetohet se i njëjti i referohej të shtënave të shkrepura nga B. Z.. I akuzuari megjithatë nuk ishte i qëndrueshëm në dëshmitë e veta lidhur me atë se *kur* kishte nxjerrë revolen. Në një version, ai kishte nxjerrë revolen pasi kishte dëgjuar të shtënë e dytë. Në versionin tjetër, i akuzuari kishte deklaruar se kishte nxjerrë revolen para se të dëgjonte të shtënë e dytë.<sup>2</sup> Një mospërputhje e këtillë tregon se i akuzuari nuk jep pasqyrën e vërtetë se si është zhvilluar ngjarja.

32. B. Z. në dëshmitë e dhëna të datave 31.01.2005, 01.02.2005 dhe 03.02.2005 kishte pohuar se pasi kishte shtënë në S. M., i akuzuari kishte drejtuar revolen në drejtim të tij dhe kishte qëlluar në të. Vetëm në dëshminë e dhënë në shqyrtimin gjyqësor B.Z. nuk kishte përjashtuar mundësinë se ka mundur të ketë shtënë i pari. Gjykata e Apelit gjen se kjo dëshmia e fundit është e dyshimtë dhe konsideron se dëshmitë e tij të mëhershme janë – ashtu siç i konsideron edhe trupi gjykues – më të besueshme. Dëshmitë ishin dhënë menjëherë / një kohë të shkurtër pas ngjarjes dhe ajo çka është e rëndësishme dëshmitari në fjalë kishte dhënë të njëjtën dëshmi në disa raste.

33. Më tej, po qe se S. M. ishte agresori, atëherë gjasat do të ishin më të vogla se B. Z. kishte hapur zjarr nga revolja e vet. Është shpjegim shumë më logjik se agresor ishte i akuzuari dhe se B. Z. *pasi kishte parë këtë*, kishte nxjerrë revolen dhe kishte hapur zjarr nga ajo. Provat materiale se B. Z. kishte qëlluar nga revolja nga pjesa e brendshme e palltos janë tregues se i njëjti ishte kapur në befasi dhe sipas të gjitha gjasave kishte vepruar në me nguti, siç është konstatuar edhe nga trupi gjykues. Urrejtja dhe nxitimi do të ishin reagim normal ndaj sulmimit të mikut të tij S. M. si dhe vetë atij. Në versionin e ngjarjeve të dhënë nga i akuzuari është edhe një mospërputhje tjetër logjike: në qoftë se S. M. kishte shtënë me armë në të akuzuarin i pari, atëherë do të ishte e arsyeshme për të që po ashtu të hapte zjarr nga arma në vend se të priste të akuzuarin derisa ta nxirrte armën dhe të *shtinte me të*.

---

<sup>2</sup> Mospërputhja po ashtu përmendet edhe në aktgjykimin e kundërshtuar të trupit gjykues, shih faqet 22 - 23.

34. Gjykata e Apelit gjen se këto mospërputhje të cekura në rekapitullimin e incidentit nga ana e të akuzuarit mbështesin edhe më shumë përfundimin e trupit gjykues për t'u mos pajtuar me versionin e ngjarjeve të treguar nga i akuzuari.

35. B. Z. në mënyrë të qëndrueshme kishte mohuar se S. M. kishte armë në dorë, përderisa mbrojtja pohonte se S. M. kishte nxjerrë armën ndaj të akuzuarit. Përderisa nuk diskutohet se S. M. ishte i armatosur, nuk është vërtetuar se vërtet i njëjti kishte nxjerrë armën ndaj të akuzuarit. Vetëm një dëshmitar ka deklaruar se e kishte parë revolen në duart e S. M. gjatë konfrontimit – ky është dëshmitari I. S. Ky dëshmitar nuk ka dhënë dëshminë gjatë fazës hetimore, por vetëm në shqyrtimin gjyqësor të datës 13 prill 2011. S. ka deklaruar se B.Z. kishte hapur zjarr i pari dhe se dy burrat e tjerë – S. M. dhe i akuzuari – po ashtu kishin armë. Megjithatë, i njëjti kishte thënë se ato armë i kishte parë “më vonë”. Asnjëri prej dëshmitarëve të tjerë nuk kishte parë revolen në duart e S. M.. Nga ana tjetër, disa dëshmitarë kanë deklaruar se arma i kishte rënë nga trupi S. M. derisa po futej në veturë pas këtij incidenti. Në këtë aspekt, përmenden dëshmitarët B. T., A. G. dhe S. B. Siç theksohet me të drejtë nga trupi gjykues, provat e dëshmitarit B. U. janë të rëndësishme së posaçme lidhur me këtë çështje. Dëshmitari B. U. në të vërtetë ka deklaruar se derisa ishin duke e ngritur nga toka për ta futur në veturë, duart e S. M. ishin të varura dhe të lëshuara. Për këtë arsye, S. M. nuk ka pasur mundësinë të mbante armën në dorë. Për më tepër, po qe se S. M. vërtet kishte nxjerrë armën e vet ndaj të akuzuarit, ajo armë do të ishte gjetur në tokë pranë S. M. apo përfundi të njëjtit. Kjo armë nuk do t'i “kishte rënë prej trupit” siç përshkruhet nga dëshmitarët të cilët e kishin ngritur nga toka. Prandaj, është përfundim logjik, siç është konstatuar me të drejtë nga trupi gjykues se arma ishte në brezin e S. M. apo e fshehur ndryshe në trupin e tij dhe se e njëjta ishte liruar dhe kishte rënë përtokë derisa po e çonin S. M.. Trupi gjykues prandaj kishte të drejtë kur nuk i kishte besuar dëshmisë së dëshmitarit I. S. se S. M. mbante armë. Duke konsideruar faktin se asnjë prej dëshmitarëve të tjerë nuk kishte parë revolen e S. M. dhe duke pasur parasysh mënyrën se si e njëjta u gjet (“duke i rënë nga trupi”), edhe Gjykata e Apelit po ashtu është e bindur se S. M. nuk kishte nxjerrë armën ndaj të akuzuarit gjatë konfrontimit të tyre.

36. Mbrojtja po ashtu kundërshton konstatimin se i akuzuari dhe S. M. e njihnin njëri tjetrin dhe se takimi i tyre më datën 31.01.2005 ishte një takim i rastësishëm. Gjykata e Apelit së pari vëren se në qoftë se raporti ndërmjet tyre dhe karakteri i takimit të tyre ka mund të jetë i rëndësishëm lidhur me pohimin e prokurorisë së bërë në aktakuzë se i akuzuari ka vepruar i shtyrë nga gjakmarrja kur ka vrrarë S. M.,<sup>3</sup> fakt ky që ka humbur rëndësinë me refuzimin e kësaj pike të aktakuzës nga ana e trupit gjykues. Objektivi i mbrojtjes gjatë pasimit të këtij argumenti është disi i paqartë, pasi që cilësimi i veprës si *vrasje e rëndë* është refuzuar nga trupi gjykues. Gjykata e Apelit megjithatë pajtohet me gjetjen e trupit gjykues dhe me arsyetimin e prezantuar në aktgjykim se i akuzuari dhe S. M. kanë njohur njëri tjetrin por janë takuar rastësisht më 31 janar 2005. Argumentet e parashtruar nga mbrojtja në ankesën e tyre lidhur me këtë pikë nuk e dëmtojnë këtë gjetje.

37. Si përfundim, Gjykata e Apelit gjen se trupi gjykues në mënyrë korrekte dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike në bazë të analizës së kujdesshme të provave. Trupi gjykues ka shqyrtuar provat në mënyrë të ndarë dhe së bashku dhe në mënyrë të kujdesshme ka vlerësuar

<sup>3</sup> Prokuroria kishte ndërtuar rastin e tyre duke u bazuar mbi faktin se motivi i të akuzuarit ishte “gjakmarrje e paskrupullt ngase S. M. ishte dëshmitar kundër të ashtuquajturit grup i Dukagjinit [...] lidhur me vdekjen e të vëllait S. M. për vrasjen e të cilit axha i të pandehurit R. A. është shpallur fajtor së bashku me disa persona të tjerë.”



mospërputhjet në mes të provave. Gjykata e Apelit pajtohet plotësisht me vlerësimin e bërë nga trupi gjykues dhe vërteton gjetjet e tij.

#### **4.4. Pohimet rreth shkeljeve të ligjit penal sipas nenit 404 të KPPK-së**

38. Mbrojtja pretendon se trupi gjykues ka gabuar në zbatimin e ligjit penal kur ka refuzuar argumentin e mbrojtjes së nevojshme në bazë të nenit 8 të KPK-së. Mbrojtja pretendon se shkelja e ligjit penal është si pasojë e drejtpërdrejtë e vërtetimit të gabueshëm të gjendjes faktike.

39. I akuzuari ka pranuar se ka vrarë S. M. por i njëjti pretendon se e ka bërë këtë në mbrojtje të nevojshme gjatë konfrontimit kur S. M. kishte nxjerrë armën kah i akuzuari i cili në të njëjtën kohë kishte dëgjuar këto të shtëna duke u shkrepur.

40. Trupi gjykues ka refuzuar versionin e ngjarjeve sipas të të akuzuarit dhe rrjedhimisht kishte përfunduar se i akuzuari nuk kishte vepruar në mbrojtje të nevojshme e cila do t'i kishte shndërruar veprimet e tij në veprime të ligjshme.

41. Gjykata e Apelit ka konfirmuar gjetjet faktike të trupit gjykues (shih më lart pikën 4.3.). Gjykata e Apelit po ashtu konstaton se trupi gjykues nuk ka shkelur ligjin penal duke refuzuar argumentin e mbrojtjes së nevojshme të parashtruar nga mbrojtja e të akuzuarit. Siç është konstatuar më lart, S. M. nuk ka sulmuar të akuzuarin dhe nuk ka nxjerrë revolen ndaj tij gjatë konfrontimit.

42. KPK-ja e përkufizon mbrojtjen e nevojshme si në vijim: “Mbrojtja e nevojshme është mbrojtja e cila është e domosdoshme për të zbrapsur sulmin e kundërligjshëm, real dhe të atqasshëm ndaj vetes ose ndaj një personi tjetër me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi.”<sup>4</sup>

43. Gjykata e Apelit gjen se në këtë lëndë nuk janë plotësuar kushtet e nevojshme. Siç është shtjelluar më lart, i akuzuari nuk është përballur me një sulm real dhe të menjëhershëm dhe edhe në qoftë se ka qenë puna ashtu, reagimi i tij nuk ka qenë në asnjë rast proporcional. Në të vërtetë është vërtetuar se S. M. nuk ka nxjerrë revolen prandaj gjithçka nga e cila i akuzuari është dashur të mbrohet ka qenë në rastin më të keq konfrontimi verbal apo fizik me S. M..

44. Gjykata e Apelit lidhur me zbatimin e ligjit penal po ashtu vëren se më datën 1 janar 2013 në Kosovë ka hyrë në fuqi Kodi i ri penal nr. 04 / L - 082). Duke pasur parasysh parimin për zbatimin e ligjit më të favorshëm për të akuzuarin, siç përcaktohet me nenin 2, par. (2) të KPK-së së vjetër si dhe me nenin 3, par. (2) të Kodit të ri, Gjykata e Apelit ka vlerësuar nëse kodi i ri do të mund të konsiderohej si ligj më i favorshëm për të akuzuarin. Në atë lëndë, Gjykata e Apelit do të duhej të aplikonte kodin e ri duke përfshirë rregullin e përgjithshëm të zbatimit të kodit në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale. Gjykata e Apelit ka vlerësuar dispozitat përkatëse në të dyja kodet dhe ka gjetur se Kodi i ri penal i Kosovës, në fuqi nga data 1 janar 2013 *nuk është* ligj më i favorshëm për të akuzuarin. Për këtë arsye, ligji penal i zbatuar në këtë lëndë është Kodi Penal i Kosovës (KPK) në fuqi nga data 31 janar 2005, pra në kohën kur është kryer vepra penale në fjalë.

#### **4.6. Pretendimet rreth vendimit mbi sanksionin penal**

---

<sup>4</sup> Neni 8 i KPK-së.

45. Trupi gjykues ka dënuar të akuzuarin me burgim në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) vjetësh burgim duke u mbështetur në nenet 6, 11, 15, 31, 32, 33, 34, pikat 1 dhe 2, 38, 64, paragrafin (1), 65 par. (1), 73 par. (1), 99 par. (1), 146 të KPK-së.

46. Trupi gjykues ka marrë në konsideratë rrethanat rënduese në vijim kur ka caktuar dënimin për të akuzuarin: (i) që i akuzuari ka qëlluar viktimën në një vend publik, (ii) që i akuzuari nuk ka shfaqur keqardhje për veprën në fjalë, (iii) që i akuzuari kishte gënjyer kur kishte thënë se kishte vepruar në mbrojtje të nevojshme. Si rrethanë lehtësuese, trupi gjykues ka konsideruar faktin që (i) i akuzuari nuk është dënuar më herët për vepra penale dhe (ii) sjellja e tij gjatë gjykimit ka qenë shembullore.

47. Mbrojtja me të drejtë argumenton se “të gënjyerit” nuk paraqet rrethanë rënduese. Gjykata e Apelit përsërit edhe një herë se mënyra se si i akuzuari e bën mbrojtjen e vet (në këtë lëndë duke pretenduar se ka qenë në mbrojtje të nevojshme) nuk mund të konsiderohet si rrethanë rënduese pasi që kjo gjë do të pengonte të drejtën e të akuzuarit për t’u mbrojtur. Për më tepër, Gjykata e Apelit thekson se për dallim nga dëshmitarët, i akuzuari nuk është i obliguar të tregojë të vërtetën kur të jep dëshminë në gjykatë, prandaj i njëjti nuk mund as të sanksionohet në qoftë se gjykata nuk i beson dëshmisë së tij për ngjarjet në fjalë.

48. Ankesa më tej thekson se trupi gjykues nuk kishte marrë parasysh si rrethanë lehtësuese moshën e të akuzuarit si dhe të kaluarën e tij. Gjykata e Apelit nuk konsideron që mosha e të akuzuarit duhet të merret si rrethanë shumë lehtësuese sepse e njëjta përkon disi me faktin se i akuzuari nuk ka të kaluar kriminale. Një i pandehur i ri për nga mosha vetvetiu nënkupton se ka më pak mundësi sesa një i pandehur më i moshuar që të ketë kryer vepra penale. Për këtë arsye, zakonisht edhe mosha edhe mungesa e të kaluarës kriminale do të konsiderohen si rrethanë e rëndësishme për llogaritjen e dënimit, por vetëm në rrethanat specifike.

49. Gjykata e Apelit megjithatë konsideron se trupi gjykues në caktimin e dënimit, është dashur të konsideronte si rrethanë lehtësuese kohën që ka kaluar që nga kryerja e veprës penale. Në kohën e dënimit gjashtë vjet kishin kaluar nga kryerja e veprës penale. Gjykata e Apelit vëren se në këtë fazë, me përfundimin e procedurës ankimore, mbi tetë vjet kishin kaluar që nga kryerja e veprës penale në fjalë.

50. Duke u bazuar në rivlerësimin e rrethanave rënduese dhe lehtësuese, Gjykata e Apelit gjen se dënimi i shqiptuar prej 15 (pesëmbëdhjetë) vjet burgim është i tepruar. Sipas nenit 64, par. (1) të KPK-së dënimi duhet patjetër të jetë proporcional me peshën e veprës dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryerësit. Duke pasur parasysh nenin 146 të KPK-së për veprën penale të *vrases* i cili përcakton dënimin me burgim prej së paku pesë vjetësh, Gjykata e Apelit përcakton se dënimi i duhur i cili do t’i shqiptohej të akuzuarit në këtë rast do të ishte dënimi prej 9 (nëntë) vjetësh burgim. Gjykata e Apelit gjen se ky dënim do të përmbushë qëllimet e dënimit të përcaktuara me nenin 34 të KPK-së.

51. Rrjedhimisht, Gjykata e Apelit pranon ankesën e mbrojtjes lidhur me atë se ankesa kundërshton dënimin e shqiptuar. Aktgjykimi i kundërshtuar prandaj ndryshohet në pjesën e dënimit ashtu që dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit për kryerjen e veprës penale të *vrases* sipas nenit 146 të KPK-së është nëntë (9) vjet burgim. Koha e kaluar në paraburgim do t’i llogaritet të akuzuarit në vuajtjen e dënimit.

52. Ankesa e mbrojtjes refuzohet për të gjitha pikat tjera dhe aktgjykimi i ish – Gjykatës së Qarkut të Pejës nr. 87 / 11 i datës 3 qershor 2011 vërtetohet duke mos u ndryshuar përkitazi me dënimin e shqiptuar.

53. Për këtë arsye vendoset si në dispozitiv.

*Përgatitur në gjuhën angleze si gjuhë të autorizuar.*

Kryetarja e kolegjit

\_\_\_\_\_

Hajnalka Veronika Karpati

Gjyqtare e EULEX-it

Anëtari i kolegjit

Anëtari i kolegjit

Procesmbajtësja

\_\_\_\_\_

Xhevdet Abazi

\_\_\_\_\_

Abdullah Ahmeti

\_\_\_\_\_

Beti Hohler

Gjyqtar

Gjyqtar

Zyrtare ligjore e EULEX-it

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

**Pakr 46 / 13**

**28 mars 2013**